



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2787 Dt 07.11.2022

Në bazë të nenit 49, paragrafi 1, nënparagrafi 9, të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022, mori:

VENDIM

1. Aprovohet draft-Rregullorja për Këshillin Kërkimor në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja për Këshillin Kërkimor në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Senat.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Menaxhmentit.
3. Fakulteteve
4. Zyrës për komunikim me publikun

Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit të UIBM




**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 2787 Dt. 07.11.2022

Në bazë të nenit 49, pika 1.9, të Statutit të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2022, miratoi:

**RREGULLORE
PËR KËSHILLIN KËRKIMOR TË UNIVERSITETI "ISA BOLETINI", NË
MITROVICË**

**Neni 1
Qëllimi**

Rregullorja për Këshillin Kërkimor të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë (tash e tutje UIBM), (në tekstin e mëtejme: Rregullore), përcakton themelimin, detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet e Këshillit Kërkimor.

**Neni 2
Themelimi i Këshillit Kërkimor**

1. Këshilli Kërkimor i UIBM, themelohet nga Senati.
2. Anëtar të Këshillit Kërkimor janë:
 - 2.1. Prorektori për hulumtime dhe kërkime shkencore;
 - 2.2. Prorektori për mësimdhënie dhe çështje të studentëve;
 - 2.3. Nga një përfaqësues nga njësitet akademike, si dhe
 - 2.4. Një student/e.
3. Anëtarët e propozuar nga njësitet akademike duhet të kenë përvojë të dëshmuar në kërkime dhe së paku titullin akademik prof. asoc. dr. Po ashtu, studenti anëtar duhet të ketë notën mesatare 8 apo më të lartë, dhe të jetë i nivelit Master ose Doktoratë.

**Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kërkimor (KK) të UIBM**

1. Detyrat e KK janë:
 - 1.1. Të zhvillojë dhe zbatojë Planin Strategjik Kërkimor (PSK) të UIBM.
 - 1.2. Të identifikojë dhe nxjerrë në pah sfidat kryesore, në lidhje me elementet kyçe të PSK.
 - 1.3. Të monitorojë zbatimin e PSK dhe vlerësojë ndikimin e saj.
 - 1.4. Të formojë nëngrupe, siç mund të kërkohet nga PSK, për hartimin e dokumenteve dhe kryerjen e detyrave të caktuara.
 - 1.5. Të monitorojë zhvillimet dhe trendet e brendshme dhe të jashtme, t'i marrë ato në konsideratë në zhvillimin e strategjisë dhe politikave kërkimore.
 - 1.6. Të kryejë detyrat dhe të marrë përgjegjësitë e dala nga Rregullorja për etikë kërkimore;



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- 1.7. Të vlerësojë zbulimet/inovacionet, sipas kërkesës së Rregullore për Pronësi Intelektuale dhe Transferim të Teknologjisë;
 - 1.8. Detyra tjera që do të dalin nga Rregullorja për kërkime, për të nxitur dhe promovuar aktivitetet kërkimore në UIBM.
2. Përgjegjësitë e KK janë:
- 2.1. Të veprojnë në interes të plotë të pjesëmarrësve në kërkim dhe komuniteteve, duke marrë parasysh nevojat e studiuësve dhe duke pasur parasysh kërkesat e agjencive rregullatore përkatëse dhe ligjet në fuqi;
 - 2.2. Të hartojë planet vjetore të punës që reflektojnë aktivitetet në realizmin e planit strategjik kërkimor;
 - 2.3. Të dorëzojë raporte të rregullta vjetore në Senat dhe sipas kërkesës nga Senati.

Neni 4

Obligimet e anëtarëve të Këshillit Kërkimor

1. Obligimet e anëtarëve të KK janë:
 - 1.1. Të deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në rolin e tyre si anëtarë të Këshillit;
 - 1.2. Të deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në performancën e tyre;
 - 1.3. Të hartojnë rregulloren e brendshme të punës;
 - 1.4. Të veprojnë në bazë të kësaj rregullore, akteve normative të UIBM dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Mandati i anëtarëve të Këshillit Kërkimor

1. Anëtarët e KK kanë mandat tre (3) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat të 30% të anëtarëve të KK.
2. Mandati i të rizgjedhurve përcaktohet përmes votimit të fshehtë të anëtarëve të KK.
3. Studenti i dërguar nga Parlamenti Studentor ka mandat një vjeçar.

Neni 6

Interpretimi

Interpretimin e kësaj Rregullore e bën Senati i Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë.

Prof. dr. Ajush Musaj

Kryesues Senatit